

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Argjentina kërcënon Britaninë me padi ndërkombëtare për naftën në Ishujt Falkland
ADRESA	https://piranjat.al/sport/argjentina-kercenon-britanine-me-padi-nderkombetare-per-naften-ne-ishujt-f-i106569
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 10:54:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 10:43:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	981d772930a8da3b13f7998b383801c1f4c2d75b37098439ce25e3e319f83904
TEKSTI	c59793389c97bd6ce4cec629de91c04bea1858c0825a43bb11c439403e58c775
PAMJA	9870d2ed9e7b2890818e764faef0cd4bed4140082f017b20aa8912fce1c1cca1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3a29f06c4ec87af2c74290cd0a899dad5ceb53a0b8ca892b87171c254426d085
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	53474bde5b7511e7be881f3c323a8b9435c3b5b0c682d69d6abb6eee18e3a200
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3a29f06c4ec87af2c74290cd0a899dad5ceb53a0b8ca892b87171c254426d085>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: **GJKKO** GJKKO-së lidhur me... **Mafia shqiptare** Ekuador. Një nga figurat **në SPAK ministria** ministren e Shëndetësisë Klodiana **në mbledhjen e** marrë pjesë në mbledhjen **të Kujdesit Shëndetësor** Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit

SPORT

Argjentina kërcënon Britaninë me padi ndërkombëtare për naftën në Ishujt Falkland

Piranjat Përditësimi i fundit 29 Shtator 2026, 12:43



Presidenti i Argjentinës Javier Milei ka kërcënuar se do të ndërmarrë hapa ligjorë kundër Mbretërisë së Bashkuar nëse Londra nuk ndalon kërkimet dhe projektin e nxjerrjes së naftës në brigjet e Ishujve Falkland, të cilët në Argjentinë njihen si Malvinat.

Në një reagim në rrjetet sociale, Milei i ka vendosur një afat prej dy javësh projektit të fushës së naftës Sea Lion, një sipërmarrje e përbashkët mes kompanive britanike dhe izraelite, duke kërkuar që ai të anulohet.

Presidenti argjentinës deklaroi se, nëse kërkesa nuk përbushet brenda këtij afati, ka udhëzuar Ministrinë e Jashtme dhe ekipet ligjore të vendit të nisin procedurat për arbitrazh ndërkombëtar kundër Britanisë së Madhe. Milei e ka cilësuar projektin Sea Lion si shfrytëzim të paligjshëm të burimeve të Argjentinës dhe paralajmëroi se çështja mund të dërgohet edhe në Tribunal Ndërkombëtar.

Kërcënimin i ri vjen në një kohë kur tensionet mes Buenos Airesit dhe Londrës për sovranitetin mbi ishujt janë rritur. Milei kishte kritikuar ashpër edhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara gjatë fjalimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme, duke e akuzuar se nuk ka ndërmarrë veprime për çështjen e Falklandeve.

Nga ana tjetër, kompanitë e përfshira në projekt argumentojnë se operacionet e tyre mbështeten në licenca të vlefshme të lëshuara nga autoritetet britanike të Ishujve Falkland. Fusha e naftës Sea Lion ndodhet rreth 209 kilometra larg ishujve dhe vlerësohet të përmbajë rreth 1.7 miliardë fuçi naftë. Kompanitë britanike Rockhopper Exploration dhe izraelite Navitas Petroleum pritet të nisin nxjerrjen e naftës nga fusha brenda dy viteve.

Çështja lidhet drejtpërdrejt me konfliktin e gjatë për sovranitetin e Falklandeve. Në vitin 1982, forcat argjentinase zbkruan në ishuj për të rivendosur pretendimin territorial, duke shkaktuar një luftë 74-ditore me Britaninë e Madhe. Një task-forcë britanike dëboi forcat argjentinase nga ishujt, ndërsa konflikti u kushtoi jetën 255 ushtarakëve britanikë, tre banorëve të ishujve dhe 649 ushtarakëve argjentinës.

Në një referendum të zhvilluar në vitin 2013, banorët e Ishujve Falkland votuan me shumicë dërrmuese për të mbetur territor britanik përtej detit. Rreth 99.8% e votuesve mbështetën këtë status, ndërsa vetëm tre persona votuan kundër.

Artikuj te sugjeruar

[Vëmendja te sfida në Sevilja, Spanja dhe Kroacia gati për të dhuruar spektakël](#)

Vëmendjen e gjithë botës sot e merr supersfida në Sevilja. Një përballje mes dy prej skuadrave më të forta të Europ...

SPORT 29 Shtator12:29

[60 mijë vende, Roma shumë shpejt me një stadium të ri, miratohet projekti](#)

Pas vitesh pritjeje, projekti për stadiumin e ri të Romës hyn në fazën vendimtare. Më 28 shtator 2026 është dhën&...

SPORT 29 Shtator12:14

[FIFA akuzon UEFA-n për "fushatë dezinformimi" dhe përpjekje për të ndikuar në zgjedhjet presidenciale](#)

FIFA ka akuzuar UEFA-n për një "fushatë dezinformimi" dhe për përpjekje për të ndikuar në garën p&eum...

SPORT 29 Shtator11:43

[Klopp nuk po bind, humbja ndaj Greqisë nuk kapërdihet, nisin kritikak e para](#)

Fishkëllima të shumta në fund të ndeshjes në WWK Arena, aty ku Gjermania u mposht 0-1 në shtëpi nga Greqia. Për Jü...

SPORT 29 Shtator10:41

[EMRI/ Tragjike! Goditi kokën gjatë ndeshjes së futbollit, ndërrojnë jetë 16-vjeçari shqiptar](#)

Një ngjarje tragjike ka tronditur futbollin në Kavala të Greqisë, pasi një futbollist 16-vjeçar, me origjinë shqiptare, k...

SPORT 29 Shtator10:27

[Trajneri Jorge Jesus tregon pse nuk e aktivizoi Cristiano Ronaldon ndaj Norvegjisë](#)

Jorge Jesus, trajneri i Portugalisë, shpjegoi arsyet pse nuk e aktivizoi Cristiano Ronaldon, i cili mbeti në stol në fitoren 2-1 të së...

SPORT 29 Shtator10:23

[Zidane ndryshon 9 lojtarë, Franca mposht Belgjikën dhe kryeson me pikë të plota](#)

Në pak ditë, Zinedine Zidane bëri një rotacion thuajse të plotë, ku ndaj Belgjikës kishte hedhur një formacion ndryshe, ...

SPORT 29 Shtator08:44

[Largimi i papritur i Cuestas nga Parma, Gilardino merr drejtimin e skuadrës](#)

Lëvizje e papritur te Parma në Serie A. Carlos Cuesta është larguar nga posti i trajnerit, ndërsa klubi italian ka arritur marrëve...

SPORT 29 Shtator08:42

[Gëzimi i shfrenuar i Zidanes pas golit të Olise: "Isha plotësisht me të"](#)

"Sapo e pashë të fillonte driblimin e tij, e dija që do të shënonte", tha Zinedine Zidane, trajneri i ri i kombëtares fra...

SPORT 29 Shtator08:09

[Vëllezërit Esposito bëjnë histori me Italinë, përsëritet rekordi i vitit 1915](#)

Italia po përballët me Turqinë në Bursa, në një ndeshje që po shënon një moment historik për kombëtaren ital...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 28 Shtator

[VIDEO tronditëse/ Oficeri i policisë në pension...](#)

Ali Sekeroğlu kishte bërë thirrje për pjesëmarrje në një demonstratë kundër pensioneve të pamjaftueshme, përme...

BOTA 28 Shtator

[Krimi horror/ Pedagogia ‘Satana’ copëtoi trupin...](#)

Është Nicole Formichetti, 46 vjeçe, pedagogia që jetonte në apartamentin në rrugën "Tommaso Gulli" në Tori...

AKTUALITET 28 Shtator

["Do të më vrasin bandat"/ Shqiptari fiton të dr...](#)

Një gjyqtar britanik i dha anonimitet një shtetasi shqiptar, i dënuar disa herë për vjedhje dhe që përballlet me dëbimi...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.